

LIGJ
Nr.8431, datë 14.12.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paragrafi i tretë i nenit 460 i Kodit të Procedurës Civile ndryshohet si vijon:

“Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatesat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.

Për çështjet me rigjykim, kur është mbajtur për gjykim në fakt, ose kur çmohet një gjykim përpara afatit 10 ditor, njoftimi u bëhet drejtpërdrejt palëve, përfaqësuesve ose mbrojtësve të tyre dhe prokurorit.”

Neni 2

Në nenin 461 të Kodit të Procedurës Civile shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Mosparaqitja e palëve, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje, nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën.

Gjykata nuk mund të shqyrtojë çështjen në mungesë atëherë kur dëgjimi i palëve është një nga detyrat e rigjykimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt.”

Neni 3

Në nenin 467 shtohen shkronjat e mëposhtme, si dhe tre paragrafë pas tyre:

“d. Nuk është formuar drejt ndërgjyqësia.

e. Kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit.

ë. Kur lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë.

Gjykata e rrethit në rigjykim është e detyruar t’i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të.

Me vendim të ndërmjetëm, gjykata mund të mos kryejë veprime të caktuara kur për rrethana të reja të dala në rigjykim, shihen të panevojshme. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë.

Në rigjykim nuk mund të ngrihen pavlefshmëritë e vërtetuara në gjykimet e mëparshme, kur vendimet përkatëse nuk janë prishur për to dhe nuk mund të bëhen pretendime të ndryshme nga ato që janë të pranura në vendimin e gjykatës së apelit, përveç nevojës për realizimin e detyrave të vëna nga ajo gjykatë.”

Neni 4

Shtohet neni 467/a me këtë përmbajtje:

“Gjykata e apelit kur prish vendimin nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë.

Kur vendimi priset për shkak të moszbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata më e lartë, pa u marrë vendim i veçantë sipas nenit 467 të këtij Kodi, gjykata e apelit, me kërkesë të palëve

ngarkon trupin gjykues përkatës me shpenzimet e bëra për këtë shkak.

Neni 5

Neni 473 ndryshohet si vijon:

“Kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, të bëjnë rekurs në kolegjet e bashkuara, brenda 3 vjetëve nga marrja formë të prerë të vendimit.

Rekursi shqyrtohet në dhomën e këshillimit nga një kolegji seleksionues i përbërë nga pesë gjyqtarë të caktuar me short. Në kolegjin seleksionues nuk mund të jenë gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen. Kolegji cakton me short nga gjiri i tij relatorin.

Vendimi për kalimin e rekursit në gjykim merret me shumicë votash.

Relatori i çështjes në kolegjet e bashkuara caktohet me short nga gjyqtarët që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes, ashtu dhe në kolegjin seleksionues.

Gjykimi në kolegje të bashkuara për të njëjtën çështje mund të bëhet vetëm një herë.

Neni 6

Në nenin 485 të Kodit të Procedurës Civile, në shkronjën “c” të hiqen fjalët “dhe të vendimit të shkallës së parë”.

Neni 7

Në fund të nenit 497 shtohet një paragraf me këtë përmajtje:

“Kërkesa e paraqitur pa u plotësuar ose në kundërshtim me kriteret e mësipërme kthehet për plotësim nga gjykata dhe në rast pretendimi të kundërt, paraqitur brenda afatit të caktuar, kalon për shqyrtim paraprak detyrimisht.”

Neni 8

Neni 499 ndryshohet si vijon:

“Shqyrtimi paraprak

Kërkesa e rishikimit shqyrtohet paraprakisht nga gjykata në dhomën e këshillimit, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, me pjesëmarrje të detyrueshme të prokurorit dhe pa praninë e palëve. Në trupin gjykues nuk mund të marrë pjesë gjyqtari që ka gjykuar çështjen.

Kur është rasti i parashikuar nga paragrafi i fundit i nenit 487, kur kërkesa është paraqitur nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, kur nuk përmban ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 494 i këtij Kodi, si dhe kur është haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e kërkesës për gjykim, në të kundërtën, kalon çështjen për gjykim.

Vendimi u komunikohet drejtpërdrejt palëve.

Vendimi i mospranimit mund të apelohej nga ai që ka paraqitur kërkesën ose nga prokurori, sipas rregullave të përgjithshme.

Kundër vendimit të kalimit të çështjes për gjykim kanë të drejtën e apelit pala e interesuar dhe prokurori.

Kur mospranimi është për shkaqet e parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 497, ose personi që nuk e ka të drejtën, kërkesa mund të riparaqitet vetëm po të plotësohen mangësitë e konstatuara nga gjykata.”

Neni 9

Neni 501 ndryshohet si vijon:

“Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës gjykata vendos refuzimin e saj si të pabazuar, pranimin e kërkesës dhe prishjen tërësisht ose pjesërisht të vendimit objekt rishikimi, zgjidhjen e çështjes në fakt dhe, kur kjo është e pamundur, kalimin e çështjes për shqyrtim sipas rregullave të

përgjithshme.”

Neni 10

Në nenin 510 shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“d. Aktet noteriale me të cilat autorizohet shlyerja e një detyrimi kontraktual ose çdo detyrim tjetër të mëparshëm, drejtpërdrejt nga depozitat bankare ose nga paga e autorizuesit dhe në kreditë e tij te të tretët.”

Neni 11

Neni 606 i Kodit të Procedurës Civile ndryshon si vijon:

“Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi ka të drejtën e gjobitjes deri 30 000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit.

Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Ndaj personave të tjerë, që sipas urdhrorit të ekzekutimit ose ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara, në rastet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, me kërkesë të përmbaruesit, gjoba caktohet nga gjykata.

Vendimi i gjykatës mund të apelohe brenda 5 ditëve nga shpallja ose komunikimi.

Neni 12

Nenet 607 dhe 608 shfuqizohen.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2282, datë 28.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**